



Universiteti Bujqësor i Tiranës

Nr. Prot. 680 Tiranë, 10.03.2022



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Nr. Prot. \_\_\_\_\_ Prizren, \_\_\_\_\_ .2022

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mes të

**UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRIZREN**

Dhe

**UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS**

**Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren**, institucion i arsimit të lartë në Kosovë, me adresë rr. "Shkronjat" nr.1, Prizren, i përfaqësuar nga u. d. Rektor, Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj

dhe

**Universiteti Bujqësor i Tiranës**, institucion i arsimit të lartë në Shqipëri, me adresë rr. "Paisi Vodica" 1025, Tiranë, i përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Fatbardh Sallaku.

Te dy institucionet pajtohen të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit të shumanshëm në funksion të zhvillimit institucional. Me vullnet të mirë palët u pajtuan si në vijim:

### Neni 1

#### Qëllimi i Marrëveshjes:

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është përcaktimi i fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve të sipër shënuara.

Të dyja këto institucione do të kenë qëllim të përbashkët identifikimin e iniciativave për promovimin dhe mbështetjen profesionale në zhvillimin e gjithanshem edukativ të dy institucioneve.

Rekomandimet dhe ekspertiza profesionale janë të nevojshme veçmas në: projekt-idetë, projektet rajonale dhe ndërkombëtare, projektet pilot dhe programet e caktuara që kanë segmente të rëndësishme të angazhimit me këtë marrëveshje.

## **Neni 2**

### **Forma e Bashkëpunimit**

Bashkëpunimi ndërmjet dy Universiteteve do të përfshijë:

- a) Shkëmbime të personelit akademik për procesin mësimor;
- b) Shkëmbime të pedagogëve, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarisë kërkimore shkencore;
- c) Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe formuese;
- d) Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);
- e) Shkëmbime të literaturës shkencore;
- f) Shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin institucional;
- g) Institucionalizimin e bashkëpunimit reciprok dhe të ndërsjelltë në sferën e ofrimit të ndihmës për ngritjen e kapaciteteve të studentëve të këtyre universiteteve;
- h) Bashkëpunimin në organizimin e aktiviteteve dhe/ose projekteve rajonale dhe ndërkombëtare me interes të përbashkët;
- i) Shkëmbimin e eksperiencave, praktikave dhe ekspertëve;
- j) Zhvillimin e programeve hulumtuese, projekteve kërkimore-shkencore;
- k) Organizimin e përbashkët të konferencave, trajnimeve, seminareve dhe bashkëpunimeve të tjera profesionale;
- l) Udhëheqje të temave të diplomave në të gjitha nivelet e studimeve;
- m) Njohje të ndërsjellë të thirrjeve akademike.

## **Neni 3**

### **Financat**

Të dy Universitetet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve financiare dhe potencialit të disponueshme nga secili institucion. Për detajimin e bashkëpunimit në fushat e mësipërme (1/a-k) dhe ndjekjen e zbatimit të marrëveshjes, ajo do realizohet nga i ngarkuari i Rektorit, nga secili Universitet.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk ka implikime financiare nga cilado palë, megjithatë marrëveshjet specifike dhe eventuale financiare për aktivitete të veçanta do të përcaktohen paraprakisht, nëse ka raste të tilla.

#### **Neni 4**

##### **Ndryshimi dhe plotësimi i bashkëpunimit**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi është dokument bazë dhe për ndryshimet dhe plotësimet e saj si dhe për marrëveshjet e tjera të veçanta të arritura ndërmjet palëve do të bëhen diskutime paraprake. Ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme si dhe marrëveshjet e veçanta bëhen në mënyrën si në vijim:

- Mosmarrëveshjet eventuale palët do të përpiqen që t'i tejkalojnë me mirëkuptim;
- Ndryshimet ose plotësimet e Marrëveshjes do të jenë efektive pas pajtueshmërisë së palëve dhe nënshkrimit të tyre;
- Marrëveshjet e mëtejshme lidhur me ndonjë organizim të veçantë, me të drejta dhe detyrime reciproke ndërmjet palëve, nuk do të jenë efektive përderisa nuk përpilohen dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve;

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

#### **Neni 5**

##### **Kohëzgjatja dhe efektet juridike**

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit. Afati i marrëveshjes mund të shtyhet nëse palët janë dakort për rinovimin e saj me shkrim. Nëse njëri prej Universiteteve kërkon ta zgjidhe këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara. Mos rinovimi i kësaj Marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga Universiteti interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

#### **Neni 6**

##### **Standardet dhe Konfidencialiteti**

Të dyja palët janë të detyruara të përmbushin këtë marrëveshje me ndershmëri (integritet) të lartë dhe standarde profesionale, etike dhe kompetencë. Asnjëra nga palët nuk do t'i perdorë dhe nuk do t'ju tregojë të tretëve informacionet konfidenciale të palës tjetër apo informacionet e përbashkëta përveç informacioneve që nuk bien ndesh me konfidencialitetin.

**Neni 7**  
**Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**


Palët kanë detyrimin të sillen me korrektësi kundrejt njëra-tjetrës. Kjo nënkupton përveç të tjerave që palët gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre reciproke dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre të mos cenojnë interesat e njëra-tjetrës.

Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në këtë marrëveshje në mënyrë të përsëritur nga njëra prej palëve, palës tjetër i lind e drejta që me një njoftim me shkrim 3 muaj përpara të zgjidhë marrëveshjen në mënyrë të njëanshme. Në çdo rast detyrimet ndërmjet palëve që lidhen me kohën kur marrëveshja ishte në fuqi duhet të shlyhen.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim dhe palët angazhohen të negociojnë për të gjetur një zgjidhje sa më të përshtatshme. Për çdo element ligjor që nuk është parashikuar në këtë marrëveshje palët do t'i referohen legjislacionit në fuqi. Në rast se një mosmarrëveshje nuk arrihet të zgjidhet me mirëkuptim palët i drejtohen Gjykatës për zgjidhjen e saj.

**Neni 8**  
**Hyrja në fuqi**

Palët do të fillojnë zbatimin e këtij bashkëpunimi menjëherë pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshjeje përmban 4 (katër) fletë dhe hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe dy për secilën palë dhe pasi lexohet, firmoset nga Rektorët përkatës.

PËR UNIVERSITETIN "UKSHIN HOTI" PRIZREN		PËR UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS	
Emri:	Z. Samedin Krrabaj	Emri:	Z. Fatbardh Sallaku
Pozita:	u.d. Rektor	Pozita:	Rektor
Nënshkrimi/Vula:		Nënshkrimi/Vula:	
Data/ Vendi:		Data/ Vendi:	